



CURRICULUM VITAE Prof. Dr. Bardhyl Ceku

Prof. Dr. Bardhyl Ceku është diplomuar në Universitetin i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë me rezultate të shkëlqyeshme.

Në të njëjtin fakultet merr gradën “Doktor në Ekonomi” me tezë “Studimi, analiza dhe prognoza e kërkesës për mallra në Shqipëri” dhe më pas titullin “Docent”. Titullin “Profesor” e merr në vitin 1994.

Prof. Dr. Bardhyl Ceku ka kryer edhe disa specializime në fushën e ekonomisë dhe marketingut në Universitetin Pierre Mendes (Francë); Senior School of Business, Grenoble (Francë); në Universitetin Angers (Francë), në Universitetin e Nebraskës-Lincoln (Shtetet e Bashkuara të Amerikës).

Prof. Ceku ka punuar fillimisht si lektor, si Përgjegjës i Katedrës së Tregtisë e më pas si Përgjegjës i Departamentit të Marketingut në Fakultetin e Ekonomisë në Unviersitetin e Tiranës, lektor në Universitetin e Tetovës, lektor i ftuar në Universitetin e Anger-it (Francë) etj. Që prej vitit 2008 është Dekan i Fakultetit të Ekonomisë dhe Administrimit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” .

Është autor dhe bashkëautor i disa teksteve e monografive ndër të cilat: “Bazat e Marketingut”, “Metoda të Kërkimit Shkencor”, “Drejtim Marketingu”, “Universiteti dhe Biznesi”, Kërkim Marketingu”, Udhëzues mbi Llogaritjen e Efektivitetit të Kostos dhe Përfitimet në Lidhje me Projektet me Përfitim Social”, “Marketingu: Bazat, Raste & Ushtrime”, “Marketingu: Bazat”, Marketingu: aspekte të manaxhimit” “Sistemi i Metodave të Hartimit të Prognozave”, “Metodat e Studimit, Analizës dhe Parashikimit të Kërkesës së Mallrave”, “Ekonomia dhe Organizimi i Tregtisë, i Aplikuar për Studentët e Fakultetit Ekonomik”, “Ekonomia Informale në Shqipëri dhe Implikimet e Saj”, “Organizimi i Tregtisë”, “Organizimi dhe Teknikat e Tregtisë”, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, etj.

Gjithashtu është autor në shumë artikuj shkencor të botuara brenda dhe jashtë vendit.